

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE  
Nr. 271 Vendimi

V E N D I M  
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot ne date 11.02.2013 une gjyqtarja e Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Tirane Filde Osmani, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesja Sabina Kodra, per regjistrimin si person juridik te shoqates me emetimin "Albanian Producer and Filmmakers Association" (APFA) dhe



K O N S T A T O V A

Sipas aktit te themelimit dhe statutit te nenshkruar nga anetaret themelues Dritan Huqi, Genc Përmeti, Ilir Butka, Sabina Kodra dhe Robert Budina eshte krijuar shoqata me emeritimin "Albanian Producer and Filmmakers Association" (APFA), qellimi i veprimtarise te se ciles eshte :

Përhapjen e artit dhe kulturës nëpërmjet formave promovuese dhe didaktike. mbrojtjen e interesave profesionale, ekonomike, e sociale te anëtareve te saj ne kushtet e reja te zhvillimit kinematografik ne vend, - kontributin e drejtpërdrejtë ne forumet dhe institucionet e fushës te parashikuara ne ligjin "Për kinematografinë", amendimet e herëpashershme te tij dhe legjislacionin shqiptar ne përgjithësi, - hartimin dhe realizimin e projekteve studimore, kërkimore, projektuese, këshilluese, ekzekutuese e promovuese, jo fitimprurëse ne fushën e kinematografisë, - për te kontribuar kështu në thellimin e dijeve dhe praktikave të studimit, projektimit , edukimit , prodhimit dhe distribuimi të projekteve bashkëkohore ne fushën e artit kinematografik, si dhe në eksplorimin e formave të integrimit të tyre në strukturat ndërkombëtare të këtij arti.

Keto qellime do te realizohen nepermjet programeve, projekteve dhe veprimtarive te tjera qe mbeshteten ne pjesmarrjen dhe perfshirjen e gjithe botuesve dhe institucioneve te tjera te perfshira ne kete process.

**Objekti i shoqates eshte :**

Shoqata "Albanian Producer and Filmmakers Association" për të realizuar qëllimin e saj do të shtrije objektin e veprimtarisë në disa fusha e konkretisht:

**Mbrojtja e interesave profesionale, ekonomike dhe sociale të anëtareve të saj. Përfaqësimi dhe kontributi** në forumet publike të kinematografisë të parashikuara në "Ligjin për Kinematografinë" dhe në legjislacionin shqiptar në tërsi. **Studimi** dhe kërkimi në fushat e ndryshme të artit dhe politikave ne kinematografisë. **Publikimi** dhe shpërndarja e rezultateve të tyre. Organizimi i seminareve, konferencave, simpoziumeve dhe formave të tjera të **diskutimit te tyre**. Projektimi dhe organizimi i kurseve dhe programeve të ndryshëm të **edukimit, kualifikimit dhe trajnimit** në fushat e artit kinematografik, si dhe në fushat që kanë lidhje organike me to. Projektimi dhe realizimi i **anketave, testeve, statistikave** etj., për aktivitetet në fushën artit kinematografik, si dhe në fushat që kanë lidhje organike me to. Krijimi i një infrastrukturre efektive për thithjen, përpunimin dhe shpërndarjen e **informacionit** në fushat që janë objekt i APFA. Realizimi i projekteve të **porositura** nga të tretët pa qëllim fitimi. Pjesëmarrje ne realizim dhe promovim **produkti artistik e kulturor**, nëpërmjet menaxhimit të kualifikuar, pa qellim fitimi, në favor të stimulimit të formave , modeleve apo prirjeve estetike bëshkëkohore.

Studimin dhe implementimin e formave bashkëkohore në **publicitetin** e produktit filmik dhe asistimin në këtë fushë të subjekteve të interesuara. Promovimin nëpërmjet **ekspozitave, festivaleve, panaireve, botimeve, projeksioneve, produksioneve** te ndryshme si audiovizive, televizive, kompjuterike, multimediale, seminareve, etj te **vlerave te trashëgimisë kulturore shqiptare** dhe te huaj, te traditës se folklorit shqiptar, te monumenteve te kulturës etj. Organizimin e fushatave publicitare, sensibilizuese, promovuese, stimuluese etj, mbi artin dhe kulturën shqiptare dhe te huaj. Zhvillimin e takimeve, seminareve, trajnimeve si dhe aktivitetet e tjera për arritjen dhe përbushjen e qëllimeve te Shoqatës. Konceptimin edhe realizimin e botimeve te ndryshme, publikimeve, emisioneve radio-televizive, produksioneve te ndryshme, faqe interneti për prezantimin, nxitjen, kualifikimin profesional, kulturor dhe artistik brenda dhe jashtë Shqipërisë. Integrimi kulturor dhe artistik ne rajon dhe me gjere nëpërmjet shkëmbimit te eksperiencave individuale, te grupeve, institucioneve etj. Ne krijimin e një qendre produksioni dhe distribuimi te filmave dhe veprave te tjera artistike te prodhuan nga te rinjtë. Nëpërmjet bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes ne koalicione me Organizata jo fitimprurëse, kur kjo është ne interes te veprimtarisë te shoqatës qofshin këto shoqata shqiptare apo te huaja, organizma te ndryshme apo individë qe kane te njëtin qellim ose ndajnë interes te përbashkëta me kete Shoqatën.

Shoqata nuk do te ndjeke qellime politike apo ekonomike. Ajo eshte organizate jo fitimprurese dhe jo qeveritare.

**Selia e shoqates** do te jetë ne Rrugën Myslym Shyri, Pall 1, Ap 156, Tiranë.

**Kohezgjatja** e saj eshte me afat te pakufizuar.

Organet drejtuese te Shoqatës "Albanian Producer and Filmmakers Association" janë:

1. Asambleja e Anëtarëve te Shoqatës e përbërë nga 5 anëtarët themelues.
2. Presidenti i Shoqatës

President i shoqates eshte znj. **Sabina Kodra**.

Burimet e të ardhurave të Shoqates janë të ardhurat nga kuotacioni, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të saj. Cdo burim tjeter i lejuar nga ligji.

Nisur nga gjithe sa me lart duke u bazuar ne dokumentacionin e paraqitur kerkesa eshte e drejte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 8788 dhe 8789 date 07.05.2001 si dhe ligjit 8781 date 03.05.2001

## V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqates me emertimin **"Albanian Producer and Filmmakers Association"** (APFA) qellimi i **veprimtarise** te se ciles sipas statutit dhe aktit të themelimit të nenshkuar nga të gjithe anetaret themeluese eshte :

Përhapjen e artit dhe kulturës nëpërmjet formave promovuese dhe didaktikë. mbrojtjen e interesave profesionale, ekonomike, e sociale te anëtarëve te saj ne kushtet e reja te zhvillimit kinematografik ne vend, - kontributin e drejtpërdrejtë ne forumet dhe institucionet e fushës te parashikuara ne ligjin "Për kinematografinë", amendimet e herëpashershme te tij dhe legjislacionin shqiptar ne përgjithësi, - hartimin dhe realizimin e projekteve studimore, kërkimore, projektuese, këshilluese, ekzekutuese e promovuese, jo fitimprurëse ne fushën e kinematografisë, - për te kontribuar kështu në thellimin e dijeve dhe praktikave të studimit,

projektimit , edukimit , prodhimit dhe distribuimi të projekteve bashkëkohore ne fushën e artit kinematografik, si dhe në eksplorimin e formave të integrimit të tyre në strukturat ndërkontinentare të këtij arti.

Keto qellime do te realizohen nepermjet programeve, projekteve dhe veprimtarive te tjera qe mbeshteten ne pjesmarrjen dhe perfshirjen e gjithe botuesve dhe institucioneve te tjera te perfshira ne kete process.

#### Objekti i shoqates eshte :

**Mbrojtja e interesave profesionale, ekonomike dhe sociale të anëtarave të saj. Përfaqësimi dhe kontributi** në forumet publike të kinematografisë të parashikuara në "Ligjin për Kinematografinë" dhe në legjislacionin shqiptar në tërsi. **Studimi** dhe kërkimi në fushat e ndryshme të artit dhe politikave ne kinematografisë. **Publikimi** dhe shpërndarja e rezultateve të tyre. Organizimi i seminareve, konferencave, simpoziumeve dhe formave të tjera të **diskutimit te tyre**. Projektimi dhe organizimi i kurseve dhe programeve të ndryshëm të **edukimit, kualifikimit dhe trajnimit** në fushat e artit kinematografik, si dhe në fushat që kanë lidhje organike me to. Projektimi dhe realizimi i **anketave, testeve, statistikave** etj., për aktivitetet në fushën artit kinematografik, si dhe në fushat që kanë lidhje organike me to. Krijimi i një infrastrukturë efektive për thithjen, përpunimin dhe shpërndarjen e **informacionit** në fushat që janë objekt i APFA. Realizimi i projekteve të **porositura** nga të tretët pa qëllim fitimi. Pjesëmarrje ne realizim dhe promovim **produkti artistik e kulturor**, nëpërmjet menaxhimit të kualifikuar, pa qëllim fitimi, në favor të stimulimit të formave , modeleve apo prirjeve estetike bashkëkohore.

Studimin dhe implementimin e formave bashkëkohore në **publicitetin** e produktit filmik dhe asistimin në këtë fushë të subjekteve të interesuara. Promovimin nëpërmjet **ekspozitave, festivaleve, panaireve, botimeve, projeksioneve, produksioneve** te ndryshme si audiovizive, televizive, kompjuterike, multimediale, seminareve, etj te **vlerave te trashëgimisë kulturore** shqiptare dhe te huaj, te traditës se folklorit shqiptar, te monumenteve te kulturës etj. Organizimin e fushatave publicitare, sensibilizuese, promovuese, stimuluese etj, mbi artin dhe kulturën shqiptare dhe te huaj. Zhvillimin e takimeve, seminareve, trajnimeve si dhe aktivitetet e tjera për arritjen dhe përbushjen e qëllimeve te Shoqatës. Konceptimin edhe realizimin e botimeve te ndryshme, publikimeve, emisioneve radio-televizive, produksioneve te ndryshme, faqe interneti për prezantimin, nxitjen, kualifikimin profesional, kulturor dhe artistik brenda dhe jashtë Shqipërisë. Integrimi kulturor dhe artistik ne rajon dhe me gjere nëpërmjet shkëmbimit te eksperiencave individuale, te grupeve, institucioneve etj. Ne krijimin e një qendre produksioni dhe distribuimi te filmave dhe veprave te tjera artistike te prodhuara nga te rinjtë. Nëpërmjet bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes ne koaliciona me Organizata jo fitimprurëse, kur kjo është ne interes te veprimtarisë te shoqatës qofshin këto shoqata shqiptare apo te huaja, organizma te ndryshme apo individë qe kane te njëjtin qellim ose ndajnë interesat te përbashkëta me kete Shoqatën.

Shoqata nuk do te ndjeke qellime politike apo ekonomike. Ajo eshte organizata jo fitimprurese dhe jo qeveritare.

**Selia e shoqates** do te jete ne Rrugen Myslym Shyri, Pall 1, Ap 156, Tiranë.

**Kohezgjatja** e saj eshte me afat te pakufizuar.

Organet drejtuese te Shoqatës "Albanian Producer and Filmmakers Association" janë:

3. Asambleja e Anëtarëve te Shoqatës e përbëre nga 5 anëtarët themelues.
4. Presidenti i Shoqatës i cili perfaqeson ate ne mardhenie me te tretet

President i shoqates eshte znj. **Sabina Kodra**.

Burimet e të ardhurave të Shoqates janë të ardhurat nga kuotizioni, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të saj. Cdo burim tjeter i lejuar nga ligji.

Kundërvendimit lejohet ankim sipas ligjit.

